

20141665146

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI
HOTELIERE**

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari hoteliere (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/2004, 89/2008, 115/10, 53/11, 141/12, 164/13 dhe 187/13) në nenin 23 paragrafi 1 në pikën 2 lidhëza “dhe” pas fjalës “aerporte” zëvendësohet me presje, e pas fjalëve: “stacione hekurudhore” shtohen edhe fjalët “dhe pompa të benzinës”.

Neni 2

Në nenin 67-a paragrafi 1 në fjalinë hyrëse fjalët “3 000 deri 6 000” zëvendësohen me numrin “200”.

Neni 3

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari hoteliere.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.